

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Kryesia e Kuvendit
Mbledhja nr. 02-74/24-07
Prishtinë, më 6 shtator 2007, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës me kryetarët e grupeve parlamentare,
të mbajtur më 6 shtator 2007

Në mbledhje morën pjesë: Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë:
Sabri Hamiti, Ramë Buja, Naim Maloku, Gazmend Muhaxheri dhe Bislim Hoti, kurse
mungoi (me arsye) Xhavit Haliti.

Nga grupet parlamentare: Alush Gashi, Gjylnaze Syla, Teutë Sahatqija, Mahir Yagcilar,
Ramadan Kelmendi dhe Gjergj Dedaj.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif
Konjufca;

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skënder Durmishi dhe Liia Hanni;

Nga Kabineti i kryetarit të Kosovës: Vjosa Osmani dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të 20 gushtit 2007;
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës;
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të 20 gushtit 2007

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë të 20 gushtit 2007 u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për shqyrtim në seancën plenare të radhës dhe kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të rendit të ditës.

Kryetarët e grupeve parlamentare (të pranishëm në mbledhje) u pajtuan me propozimin e pikave të rendit të ditës për seancën e radhës, si dhe për datën e mbajtjes së saj më **14 shtator 2007**.

Pas kësaj kohe, Kryesia i zhvilloi punimet pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë, veç e veç, vendosi që Kuvendit t'ia propozojë rendin e ditës për seancën plenare më 14 shtator 2007, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 27 gushtit 2007;
2. Koha për pyetje parlamentare;
3. Interpelanca e ministrit të Arsimit, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën jokentestimore;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbaruese;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën kontestimore;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat dhe për përgjegjësitë e deputetit;

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin;
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë organike;
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor;
12. Shqyrtimi i propozimit të partive parlamentare për anëtarë në Komisionin Ad Hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së;
13. Shqyrtimi i propozimit të partive parlamentare për anëtarë në Komisionin Ad Hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media;
14. Shqyrtimi i Rekomandimit për transferin e mjeteve buxhetore të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (MBPZHR)
15. Shqyrtimi i Rekomandimit për transferin e mjeteve buxhetore të Ministrisë për Energji dhe Miniera (MEM) në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit;
16. Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me Raportin fiskal për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2007;
17. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të Bordit Drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

3. Shqyrtimi i kërkesave dhe i mocioneve

3.1. Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të Kryesisë, z. Gazmend Muhaxheri, për hartimin e Projekt-Rregullores së Kryesisë së Kuvendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e anëtarit të Kryesisë, z. Gazmend Muhaxheri, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Mbështetet kërkesa e Gazmend Muhaxheri, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, për hartimin e Projekt-Rregullores së punës të Kryesisë së Kuvendit.
2. Ngarkohet sekretari i Kuvendit, në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve që e mbështesin Kuvendit e Kosovës, ta hartojnë Projekt-Rregulloren dhe t'ia paraqesin Kryesisë për miratim.

3.2 Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të Kryesisë, z. Gazmend Muhaxheri, për përshpejtimin e procedurës në hartimin e Projektligjit për Komisionin Hetimor

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e anëtarit të Kryesisë, z. Gazmend Muhaxheri, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese që Kuvendit t'ia procedojë Projektligjin për Komisionin Hetimor deri më 20 shtator 2007.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbajtjen e Konferencës Rajonale për Çështje Mjedisore

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën Komisionit, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për organizimin e Konferencë Rajonale për Çështjet Mjedisore, në bashkëpunim me OSBE-në.
2. Kuvendi, si bashkëorganizator i kësaj konference, i përballon shpenzimet e koktejit me rastin e hapjes së saj, si dhe të darkës për pjesëmarrësit e konferencës.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për formimin e Komisionit Parlamentar për të Pagjeturit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën Komisionit, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Që Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të vazhdojë punën deri në fund të kësaj legjislature, në përputhje me përgjegjësitë që i ka në bazë të Rregullores së punës, për fushën që e mbulon.

3.5 Shqyrtimi i Propozim - Rezolutës lidhur me ndërtimet ilegale të Qeverisë së Serbisë në Veriun e Mitrovicës

Kryesia, pasi e shqyrtoi Propozim-Rezolutën e parashtruar nga Grupi Parlamentar i LDD-së, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni për Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, që në bazë të debatit të zhvilluar më 31 korrik 2007 lidhur me ndërtimet ilegale nga ana e Qeverisë së Serbisë në Veriun e Mitrovicës, t'i hartojnë **Rekomandimet** dhe Kuvendit t'ia paraqesin për miratim.

4. Të ndryshme:

4.1 Njoftimi i anëtarit të Kryesisë, z Naim Maloku, lidhur me monitorimin e punës së Komisionit për hapjen e ofertave më 27 gusht 2007

Naim Maloku, i informoi anëtarët e Kryesisë lidhur me ecurinë e hapjes së ofertave të 27 gushtit 2007, të cilën ai e vlerësoi se është zhvilluar në përputhje me Ligjin për prokurimin publik.

4.2 Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë lidhur me shkresën që ua kishte dërguar kryetarëve të grupeve parlamentare, me të cilën kërkohet të përshpejtohet me procedimin e amendamenteve për Rregulloren e punës së Kuvendit.

4.2 Sabri Hamiti shtroi çështjen e **agjendës legislative** të Kuvendit. Ai kërkoi që të dihet se deri kur kjo legjislaturë mund të miratojë ligje, ngase projektligjet e pa përfunduara do të jenë të pavlefshme për legjislaturën e ardhshme. Andaj, duhet të përgatitet një listë e projektligjeve, që janë më të rëndësishme, të cilat mund të miratohen deri në fund të kësaj legjislature.

4.4 Naim Maloku shtroi çështjen e projektligjeve të “Pakos së Ahtisarit”, për të cilat Komisioni Parlamentar për Siguri është përgjegjës për t’i shqyrtuar. Ligjet e “Pakos së Ahtisarit”, nuk janë në domenin e Rezolutës 1244 dhe nuk duhet të nënshkruhen nga PSSP-ja, por ato hyjnë në fuqi pas zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Kryesia e Kuvendit, shtoi ai, duhet të marrë vendim që ato ligje, pasi të miratohen, të mbesin në Kuvend deri sa të zgjidhet statusit i Kosovës, pastaj t’i dërgohen autoritetit përgjegjës për nënshkrim.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 11: 45 minuta.

E hartoi:
Divizioni i Çështjeve Plenare e Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA
